

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI, PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në grumbullimin, administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e materialeve të kësaj periudhe në Shqipëri;

Duke njohur bashkëpunimin e këtij Instituti me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera vendase e të huaja për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së Institutit;

Duke konsideruar se detyrat kryesore të punës së këtij Instituti kërkojnë mbështetjen e vazhdueshme të organeve shtetërore, medias, shoqërisë civile dhe partnerëve, në funksion të ruajtjes së kujtesës sonë kolektive,

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për vitin 2024 në këto drejtime:

Realizimin e një konference shkencore për artin dhe letërsinë e realizmit socialist, e cila kishte për qëllim nxjerrjen në pah, përmes një debati shkencor, të pasojave të propagandës në arte dhe në letërsi gjatë regjimit komunist.

Përkujtimin përmes disa veprimtarive të ngjarjeve të rëndësishme të qëndresës antikomuniste gjatë regjimit komunist, siç ishte revolta e të burgosurve politikë në kamp-burgun e Qafë-Barit më 22 maj 1984.

Prezantimin e punës së ISKK-së para një audience evropiane, duke bashkëpunuar me Platformën Evropiane të Kujtesës dhe Ndërgjegjes, përmes realizimit të projekteve të përbashkëta, ekspozita dhe forume me partnerët ndërkombëtarë.

- Shpërndarjen e botimeve të Institutit në 38 biblioteka bashkish dhe universitetesh në të gjithë Shqipërinë.

Kuvendi kërkon që Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për vitin 2025, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të organizojë konferenca dhe debate publike për trashëgiminë materiale të komunizmit dhe për aspekte të caktuara të saj, si: estetika e ambientit në përgjithësi, arkitektura, planifikimi urban dhe veprat monumentale.

2. Të angazhohet në hartimin e udhëzuesit praktik për mësuesit në bashkëpunim me ekspertë të historisë dhe didaktikë, dhe të ndërmarrë nisma për integrimin e këtij materiali si pjesë mbështetëse në tekstet mësimore.

3. Të zgjerojë fushën gjeografike të veprimtarive edukuese dhe të përfshijë edhe arsimin universitar përmes leksioneve të hapura, bashkëpunimeve me departamente historie, si dhe përmes projekteve të përbashkëta kërkimore-studimore.

4. Të vijojë bashkëpunimin me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për të pasuruar koleksionin e muzeve të ndryshëm në vend me botimet e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit.

5. Të sigurojë funksionalitetin dhe përditësimin e faqes zyrtare, duke publikuar në mënyrë të rregullt procesverbalet dhe vendimet e Bordit dhe të Këshillit Shkencor.

6. Të angazhohet në përgatitjen e një studimi në lidhje me strukturat e mekanizmave shtypës dhe agresorët e sistemit komunist, me qëllim dokumentimin historik dhe analizimin institucional.

Miratuar në datën 16.10.2025.

KRYETAR
Niko Peleshi